Rëndësia e të mësuarit bazuar në projekte

Të mësuarit bazuar në projekt i përgatit nxënësit për suksese akademike, personale dhe në karrierë, dhe të përballen me sfidat e jetës së përditshme.

Nxënësit punojnë për një projekt për një periudhë kohe nga një javë deri në disa muaj, duke u angazhuar me një problem të jetës reale dhe në dhënien përgjigje të pyetjeve të shumëllojshme mbi këtë problem. Gjatë këtij procesi ata demonstrojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre duke përgatitur një produkt/prezantim për një audiencë reale.

Si rezultat, gjatë projektit nxënësit zhvillojnë njohuri të thella teorike, si dhe aftësi të tjera, si të menduarit kritik, aftësitë komunikuese në kontekstin e të bërit një projekt autentik dhe kuptimplotë. Të mësuarit bazuar në projekt ndihmon në bashkëpunimin midis nxënësve dhe mësuesve.

Të punuarit bazuar në projekt integron njohuri të nxënësve të lëndëve të ndryshme, si histori, gjeografi, matematikë, TIK etj.

Më poshtë pasqyrohet një model projekti lëndor (të ekonomisë).

PROJEKT

Tema: Tregu punës në Shqipëri

Rezultatet e të nxënit të projektit

Nxënësi/ja:

- Evidenton prirjet e tregut të punës në vend në vitet e fundit;
- Analizon shkaqet e zhvillimeve/ndryshimeve në tregut të punë në vend;
- Analizon ndryshimet e forcës punëtore në nivelin e pagave;
- Sugjeron/propozon politikat që duhet të ndërmarrë shteti në forcimin/përmirësim e tregut të punës.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

Nxënësi/ja:

- Zhvillon aftësitë e komunikimit për të shqyrtuar, analizuar, parashtruar pyetje, argumentuar, diskutuar, komunikuar informacionin e gjetur, konceptet dhe idetë bazë.
- Zhvillon mendimin kritik për të interpretuar gjetjet, për të analizuar të dhëna numerike, për të ndërtuar dhe interpretuar grafikë, diagrame, tabela statistikore.
- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme, duke i klasifikuar ato sipas rëndësisë që kanë për temën;
- Ndërlidh temën me njohuri dhe çështje paraprake apo të marra në lëndë të tjera duke i paraqitur ato sipas një lidhjeje logjike;
- Zhvillon një kërkim individual dhe në grup për kryerjen e një Mëso duke vepruar të caktuar;
- Diskuton në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e së tashmes dhe në perspektivën e së ardhmes;
- Përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup, etj. për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij/saj;

- Zhvillon aftësitë qytetare për të shqyrtuar në mënyre kritike sjelljet motivet dhe veprimet e njerëzve në të shkuarën, që mund të jenë rezultat i ndryshimeve të qëndrimeve shoqërore dhe standardeve të ndryshme;
- Zhvillon aftësitë digjitale për të kërkuar, përzgjedhur dhe analizuar informacionin ekonomik;
- Përdor një sërë burimesh digjitale të informacionit;
- Prezanton punime grafike duke përdorur teknologjinë digjitale.

Lidhja me fushat e tjera

Qytetaria; Makapitulli; Gjeografia; Historia; TIK.

Metodologjia

Punë në grup; Hulumtim; Diskutim; Debat; Prezantim' Punë individuale

Mjetet

Kompjuter, lidhje me internet; Video projektor; Fotografi; Postera; Skica; grafikë.

Kohëzgjatja: 4 orë mësimore.

Ora parë- Veprimtaritë:

1. Paraqitja e temës dhe rezultateve të saj;
2. Diskutimi i nënçështjeve për hulumtim, zhvillimi i ideve;
3. Ndarja e klasës në grupe me 4-5 nxënës;
4. Prezantimi i burimeve të informacionit;
5. Përshkrimi i veprimtarive kryesore të ndara në hapa;
6. Njohja me mënyrën e vlerësimit të projektit,

Ora dytë dhe e tretë - Veprimtaritë:

1. Paraqitja dhe diskutimi në klasë/grupe i punës së bërë nga grupi gjatë një periudhë kohë të caktuar;
2. Diskutimi/ndihma nga mësuesi, nga nxënësit e tjerë, për vazhdimin e mëtejshëm të hulumtimit.

Ora e katërt*: *Veprimtaritë:

1. Prezantimi i punës së grupeve në klasë poster, poëer point, etj
2. Vlerësimi nga mësuesi dhe nga nxënësit e tjerë.

Probleme/nënçështje të cilat do të ndihmojnë hulumtimin:

- Prirjet e forcës punëtore në Shqipërisë në 20 vitet e fundit;
- Ndryshimet që ka pësuar struktura e krahut të punës sipas:
  - gjinisë (femra- meshkuj)
  - profesioneve
  - degëve të ekonomisë
  - shkallës së arsimimit
  - rajoneve/prefekturave (qytet-fshat)
- Shkaqet që kanë ndikuar në ndryshimet në prirjet e forcës punëtore;
- Ndikimi i emigracioni në krahun e punës në vendin tonë;

- Ndikimi që ka pasur dhe që do të ketë në krahun e punës rritja natyrore e popullsisë në vendin tonë;
- Ndryshimet në nivelin e pagave në 20 vitet e fundit;
- Profesionet më të kërkuar aktualisht në tregun e punës në vend;
- Sugjerime/propozime të politikave të shtetit tonë për përmirësime në tregun e krahut të punës.

Shënim: Çështjet e mësipërme janë çështje të sugjeruara; nxënësi në bashkëpunim më mësuesin mund të shtojnë apo të ndryshojnë problemet rreth të cilave do të hulumtohet.

Burimet kryesore të informacionit

- faqja zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë - *http://www.finanaca.gov.al*
- faqja zyrtare ISTAT (Instituti i Statistikave) - *//http: //www.instat.gov.al*
- Open data Albania - *http://www.open.data.al*
- Intervista me prindërit, të afërmit, sipërmarrës, punonjës shtetërorë që kanë informacion mbi tregun e punës
- Burime nga shtypi

Ndarja e detyrave

Për të realizuar Mëso duke vepruarn e mësipërme mund të ndaheni në grupe, ku secili anëtar grupi ngarkohet me një Mëso duke vepruar të caktuar. Për shembull, dikush të mbledhë informacion për çështje të caktuara, të tjerë të përzgjedhin informacionin, të tjerë të përpunojnë informacionin dhe ta përshtatin atë, dikush të ndërtojë grafikët, dikush të përgatitë prezantimet e shkruara në kompjuter apo me shkrim dore, të tjerë të përgatiten për ta prezantuar atë para klasës.

Është shumë e rëndësishme të punoni në grup dhe të zgjidhni një udhëheqës grupi që t'ju drejtojë në koordinimin e veprimeve dhe realizimin e Mëso duke vepruars.

Ndërtimi grafikëve

Sugjerohet të ndërtoni grafikë për të paraqitur çështjet e mësipërme në tregun e të krahut të punës në Shqipëri.

Vlerësimi:

Nxënësit vlerësohen për:

- pjesëmarrjen aktive të tyre në etapat e projektit;
- punën dhe bashkëveprimin në grup;
- punën e pavarur;
- aftësitë prezantuese;
- argumentimin e ideve te tyre.